REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 932/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEKO-20-093-2-1-1**
Sa i përket tenderit për : **PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT PËR MBROJTJEN KUNDËR ZJARRIT**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULNAT SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAT- PRISHTINË
(Adresa)

PRISHTINË — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

045-150-123 — /
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

BESART HALIMI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

studiohapsira@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/
(Emri i avokatit)

/

(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____

(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Më datën 03.11. 2020 jemi njoftuar mbi vendimin e eleminimit tonë
  Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Përmes platoformës elektronike , e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Më datën 03.11.2020 përmes letrës standarde për tenderuesin e pasukseshëm jemi njoftuar mbi eleminimin tonë ,dhe tenderi është anuluar

KEK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA D.D.

03 -11- 2020
Nr. 9834

Data 03.11.2020

PËR OPERATORIN EKONOMIK	Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK
NGA	KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Zyra Ekzekutive e Prokurimit, rr. Nëna Terezë nr. 36 10000 Prishtinë Flamur Bekteshi, u. d. Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit
NUMRI I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM	PERMES PLATFORMES E PROKURIMI
DATA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS	29.10.2020
SHQYTIMI I ANKESËS TË PARASHTRUAR	☒ **Eliminimi pas vlerësimit të tenderit**
TITULLI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	**Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit**
Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	**KEK-20-518-2-1-1**
Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT I BRENDSHËM	**KEKO-20-093-211**
DATA E NJOFTIMIT PËR KONTRATË	24.02.2020
DATA E PRANIMIT TË TENDERËVE	06.04.2020

Zyrtari pergjegjes i Prokurimit ne baze te nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kerkeses te parashtruar per rishqyrtim nga Grupi i Operatoreve Ekonomik **STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit**" me nr. prokurimit **KEKO-20-093-211**, Autoriteti Kontraktues mori këtë:

Vendim

Refuzohet si e pabazuar kerkesa e paraqitur per rishqyrtim nga Grupi i Operatoreve Ekonomik **STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit**" me nr. prokurimit **KEKO-20-093-211**.

Arsyetim

Me datën 29.10.2020, Autoriteti Kontrakrues KEK.sha ka pranuar kerkesën per rishqyrtim nga Grupi i Operatoreve Ekonomik **STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit**" me nr. prokurimit **KEKO-20-093-211**.

Konform nenit 108/A, te ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit te ofertave, Dosjes se tenderit dhe shqyrtimit te rrjedhjes se procedures se tenderimit, komisioni profesional vlerësues i Autoritetit Kontraktues ne baze te kerkeses per rishqyrtim te Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:

1/3

Sqarim:

- Ne kërkesën për rishqyrtim keni kërkuar rishqyrtimin e ofertës tuaj me arsyetim se A.K. ka bërë zbatim jo të drejtë të nenit 7, 51, 56, 59 dhe 60 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042.
- Pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të prezantuara, analizimit të dispozitave në fjalë, komisioni vlerësues e kundërshton kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar:

Arsyetim:

- Pretendimi se është shkelur neni 7 nuk qëndrojnë, gjate vlerësimit te ofertës tuaj nuk është bërë asnjë diskriminim.
- Pretendimi se janë shkelur nenet 51, 56, 59 dhe 60 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042 nuk qëndrojnë, A.K. gjate vlerësimit ka vlerësuar konform LPP-së.

Përgjigje në PRETENDIMIN ANKIMOR 1

Komisioni edhe pas ankesës tuaj ne lidhje me mospranimin e dy referencave mbetet në të njëjtat qëndrime sikur gjatë pocesit të vlerësimit të ofertave. Edhe një herë ju bëjmë me dije se procesi industrial në hapësirat e AK ka të bëjë me industri energjetike dhe për materie ka gazin industrial si hidrokarbur dhe se nuk kemi mundësi ta marrim si reference e ngjashme nje aktivitet që ka të bëjë me (1) prodhimine qumështit, (2) prodhimin e betonit që ju i keni sjellë në referencat 1 dhe 2. Sa i përket dallueshmërisë së madhe mes referencave që Ju si pretendues i keni sjellë dhe natyrës teknolokgjike të AK, që është objekt i këtij tenderimi, ju japim edhe disa arsye. Ne kemi për lëndë bazë në industrin tonë gaz industrial, që hyn në radhën e hidrokarbureve, andaj nuk kemi se si t'ua pranojmë si referenca të ngjashme ato që kanë të bëjnë me qumësht dhe me beton. Pra lënda që gjendet në objektin e AK e që është objekt i këtij tenderimi, është material lehtëndezës dhe hyn në radhën e materiele të rrezikshme dhe se kemi të bëjmë me proces teknologjik të shndërrimit të energjisë, ndërsa lënda (qumështi dhe betoni) e dy referencave tuaja të cilat nuk kemi mundur të t'i pranojmë janë materiale zjarrduruese, pra janë krejt e kundërta.

Per tu vërtetuar, se referencat e ofruara, nuk jane te njëjta gjegjësisht te mjaftueshme per te kënaqur kerkesen e iniciuesit me deshmit e kërkuara, per objektet industriale me shkalle te rrezikshmeris se larte nga zjarri dhe eksplodimi teknologjike, ofrojme deshmi duke u bazuar ne :
LIGJI Nr. 04/L-012 -PËR MBROJTJE NGA ZJARRI- KREU III
KATEGORIZIMI I OBJEKTEVE
Neni 7
Kategorizimi i objekteve

1. Objektet dhe pjesët e objekteve radhiten në katër kategori sipas rrezikshmërisë nga zjarri:
1.1. në Kategorinë e I (Parë) hynë objektet varësisht prej procesit teknik që zhvillohet në to;
1.2. në Kategorinë e II (Dytë) hynë objektet sipas llojit të materialit që prodhohet përpunohet apo deponohet;
1.3. në Kategorinë e III (Tretë) hynë objektet sipas llojit të përbërjes së materialeve në ndërtimtari; dhe
1.4. në Kategorinë e IV (Katërt) hynë objektet sipas rëndësisë së tyre.
2. Ministria, me akt nënligjor përcakton kriteret për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategoritë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarri.

Nga neni 7 vertetojme: Objektet industriale bazuar ne kerkesen e autoritetit kontraktues i perkasin kategoris se pare sipas rrezikshmeris nga zjarri dhe ezplodimeve teknologjike, ndersa deshmit e referencave per objektet industriale i perkasin kategorise se dyte.

Përgjigje në PRETENDIMIN ANKIMOR 2

Në lidhje me Lincencimet e personave juridike dhe certifikatave të personelit, mbesim në të njëjtat qëndrime, për arsye se punët për hartim të dokumentacioneve dhe elaboratve të Mbrojtjes nga zjarri mund t'i kryejnë vetëm personi juridik me autorizim përkatës nga AME, që është Agjencion i menaxhimit emergjent e jo Agjencion i mbrojtjes emergjente, siç e emërtoni ju. Ju keni shumë të drejtë kur thoni që të tilla agjencione kanë edhe shtet e rajonit, porse ato agjenci ato shtet i quajnë secila në mënyrën e tyre dhe asnjëra nuk quhet AME (Agjenci e menaxhimit emergjent) përveç kësaj që vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Republikën e Kosovë. Për më tej mund ta konsultoni UA nr.12/2017 për përmbajtjen e elaboratit për mbrojtje nga zjarri. (neni|5: Personi fizik dhe juridik, përveç kushteve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ duhet ta ketë edhe autorizimin për hartimin e elaboratit të cilin e lëshon AME)
Sa i përket marrëveshjes për njohjen e diplomave shkollore mes Kosovës dhe Shqipërisë, urojmë që ashtu edhe të jetë, porse sa i përket licencave dhe certifikimeve referimi duhet të jetë përherë tek AME, nëse ata i pranojnë dhe bëjnë autorizime, atëherë ato do të jenë të vlefshme edhe për ne.

REKOMANDIMI I NJËSISË KËRKUESE SI DHE ZYRES EKZEKUTIVE TË PROKURIMIT

- Komisioni profesional vlerësues bazuar në sqarimet e dhëna më lart për aktivitetin e prokurimit "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. prokurimit KEKO-20-093-211 pretendimet e Grupit të Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK i vlerson si të pabazuar.

- Komisioni profesional vlerësues rekomandon që kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK të refuzohet.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

- Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ankesën e Grupit të Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimin e komisionit profesional vlerësues për aktivitetin e prokurimit "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. prokurimit KEKO-20-093-211 ka vlerësuar se Operatori ekonomik ne ankesën e tij nuk ka prezantuar prova me të cilën e vërteton faktin se vendimi i marr nga autoriteti kontraktues nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në LPP, andaj si i tillë nuk paraqet bazë të mjaftueshme për ndryshimin e vendimit te marre me date 21.10.2020 (i publikuar me dt. 23.10.2020).
- Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marr parasysh dëshmitë e dërguara nga Operatori ekonomik si dhe rekomandimet nga komisioni ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund te paraqesë ankesë prane OSHP-së konform dispozitave ligjore te LPP-se nga data e pranimit te vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik
1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit te Prokurimit
1x1 ekzemplar – Arkivës se KEK-ut

Për u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive te Prokurimit

Flamur Bekteshi

03.11.2020

3/3

VENDIMI I AS ËSHTË SKANDALOZË JEMI ELEMINUAR PËR KRITERE TË CILIAT NUK JANË SPECIFIKUAR NË FDT DHE NË NJOFTIM PËR KONTRATË

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

NENI 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) , paragrafi 1,2,3 dhe 4
NENI 11 (Mjetet për Promovim të Transparencës)
NENI 27 (Dosja e Tenderit) , pargrafi 1 dhe 10
NENI 51 (Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes) , paragrafi 1 , 2 dhe 3
NENI 52 (Njoftimi i kritereve për dhënine e Kontratës) , paragrafi 1 , 3 dhe 10
NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .
NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
NENI 60 : Kriteret për dhënien e kontratës .
RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë) NENI 41.1 DHE 41.11

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI ANKIMORË 1 :

Prentendimi Ankimorë I AK – Nuk keni dorëzuar referenca të natyrës së ngjashme , janë kërkuar dy (3) projekte elaborate të ngjashme të hartuara për mbrojtje kundër zjarrit për objekte industrial të lëshuar nga pranuesi I shërbimit.

Këtë pretendim e hudhim si të pa bazë me arsyetimin :

Ne kemi ofruar 4 kontrata të bashkangjitura me referenca konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë të ngarkuara në e-procurim gjatë dorëzim të ofertës.

1. **HARTIMIN E ELEBORATIT PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRIT PËR NEVOJAT E KOMPLETIMIN E PËLQIMIVE DHE DOKUMENTACIONEVE PËR FABRIKËN E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT "SHARRI " NË PRIZREN :**

ARGUMENT :

Ne kemi dorëzuar ofertën e dorëzuar ne kemi bashkangjitur kontratën dhe Refrencën e lëshuar për përfundim të sukseshëm të shërbimit për hartimin e elaboratit kundër zjarrit për objektin e fabrikës për prodhimin e betonit me infrastukturën përcjellëse ..

Kontenstimi I kësaj kontrate nga ana e AK është I pa bazë , pasi fabrika e përpunimit të qumështit është object industrial konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë , pasi ka kërkuar refrenca të natyrës së ngjashme.

Ky pretentim ankimorë e konsiderojmë të gjykuar " Rest Juridicata" ,conform mendimit të ekespertit , dhe vendimit OSHP-së NR 331/20 të dates 29.06.2020

Provë material :

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkes e AK-së ne DT ka qenë:

Bazuar ne kërkesen e AK-së dhe dokumentacionit ne oferten e OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE në fjalë në oferten e tij ka të bashkangjitur listen e kontratave dhe referencat për punët e kryera me sukses si me poshshtë: Me tej eksperti shqyrtues sqaronse Industria është një degë e veprimtarisë ekonomike që synon prodhimin e një produkti ose nxjerrjen e burimeve, andaj kontrata me titull:"Hartimin elaboratit për mbrojtjen kundër zjarrit për fabrikën prodhuese qumështit në zonën Industriale" " Sharri " në Prizren është pjesë e industris, dhe si e tillëkjo fabrikë e perpunimit të qumshtit bënë pjes ne objektet e industris ushqimore.

Bazuar në proven e paraqitur dëshmon se referenca në fjalë është konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë , pasi ka kërkuar refrenca të natyrës së ngjashme.

2. HARTIMIN E ELBORATIT PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRIT PËR INDUSTRIN (FABRIKËN) E PRODHIMIT TË BETONIT „ERUROVIA SHPK" - PRIZREN:

ARGUMENT :

Ne kemi dorëzuar ofertën e dorëzuar ne kemi bashkangjitur kontratën dhe Refrencën e lëshuar për përfundim të sukseshëm të shërbimit për hartimin e elaboratit kundër zjarrit për objektin e fabrikës për prodhimin e betonit me infrastukturën përcjellëse ..

Kontenstimi I kësaj kontrate nga ana e AK është e pa bazë , pasi fabrika e prodhimin të betonit është object industrial për prodhimin e elemenetve të betonit ku përfshihet : Zona e fabrikes ku prodhohen elementet e betonit , depot për ruajtjen e elementeve të prodhuara të betonit , seperacioni I zallit , silloset për prodhimim e betonit ,objektet përcjellëse administrative , andaj konsiderojmë që kjo kontratë është konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë, pasi ka kërkuar refrenca të natyrës së ngjashme

Ky pretentim ankimorë e konsiderojmë të gjykuar " Rest Juridicata" ,conform mendimit të ekespertit , dhe vendimit OSHP-së NR 331/20 të dates 29.06.2020

Provë material :

Gjithashtu sa i perket pikes ankimore nr.2 per sherbimet e kryera per kontratën me titull:Hartimin e laboratit për mbrojtjen kundër zjarrit për fabrikën prodhuese të Betonit në Prizren. Ekspertishqyrtues duke u bazuar ne degete industrisësqaron se, industritë quhen pjesë individuale të sektorit të prodhimit, ndërmarrjet e të cilave synojnë prodhimin e produkteve specifike ku çdo industri ka teknologjinë dhe veçoritë e veta, dhe si rrjedhoj e kësaj del se Fabrika prodhuese e betonit në fjalë bënë pjesë ne industrin e ndertimit. Dhe si i till ky pretendim akimor qendron.

Bazuar në proven e paraqitur dëshmon se referenca në fjalë është konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë , pasi ka kërkuar refrenca të natyrës së ngjashme

Me këtë rast AK ka vepruar kundër vendimit të OSHP-së NR 331/20 të dates 29.06.2020

KOMENT I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME PRETENDIMIN NR 1:

Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimin të ofertës tone ka vepruar në kundërshtim me NENI 41.11 RRUOPP (Ekzaminimi , Vlerësimi dhe krahasimi I tenderëve) duke na diskualifikuar apo përjashtuar nga procedurat e prokurimit në bazë të një kërkesë apo pretendimi e cola nuk është precizuar nëdosjen e tenderit

41.11 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri **që nuk është specifikuar** në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Autorieti Kontraktus ka gjatë vlerësimit të ofertës tonë ka marrë vendim skandalos- Pasi AK në këtë rast e pranon që janë objektet industriale por nuk I takojnë kategorisë së parë me këktë rastë AK ka shkelur NENI 41.11 RRUOPP- Pasi kategorizimi i Objekteve Industriale nuk ka qenë kërkesëe përshtatshmërisë mbi mundësin teknike dhe profesionale të FDT-Së dhe njoftimit për kontratë NENI 9.1 dhe 9.2 (Por Vetë Objekte Industriale pa specifikuar kategorinë)

PRETENDIMI ANKIMORË 2 :

2. Ju nuk e plotsoni kriterin ne nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ne njoftimin për kontrate apo nenin 9.1 & 9.2 ne Dosje te Tenderit Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD) ku kërkohet "**2. Për sa i përket stafit teknik, ofertuesi duhet të përmbushë kërkesat minimale dhe njëkohësisht duhet te ketë ne marrëdhënie te rregullt të punës kuadrin e kualifikuar për menaxhim, mbikëqyrje në përgatitjen e elaboratit raportit**
   1. Dy ekspertë të licencuar nga AME me se paku tre vjet përvoje pune.
   Keni ofruar licence dhe certifikate për personelin ne fjale me prejardhje te vendeve / shteteve tjera, ndërsa ne vendin tone janë valid dhe te vlefshme vetëm licencat dhe certifikatat vendore.

Pasi AK në kërkesat e përshtatshmërisë profesionale si në vijim :

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2		**përgatitjen e elaboratit raportit** **- Dy ekspertë të licencuar nga AME me se paku tre vjet përvoje pune**

Në provën e paraqitur të nënvizuar me ngjyrë të kuqe, shifet qartë që Autoriteti Kontraktues nuk e ka precizuar vendin e origjinës , Agjencim për mbrojtjen e emergjencave i ka secili shtet (Duke filluar prej Shqiperisë , Sërbisë , Maqedonisë Veriore, dhe Malit Zi si vende fqinjë)

Me këtë rast AK na ka eleminura për një pretendim i cili nuk është specifikuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Gjatë vlerësimit, krahasimit të tenderëve AK ka vepruar në kundërshtim me NENI 41.11 RRUOPP (Ekzaminimi , Vlerësimi dhe krahasimi I tenderëve) duke na diskualifikuar apo përjashtuar nga procedurat e prokurimit në bazë të një kërkesë apo pretendimi e cola nuk është precizuar nëdosjen e tenderit.

41.11 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri **<u>që nuk është specifikuar</u>** në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

AK I KA IKUR NJË KRITERI TË TILLË

Ne kemi ofruar licensa për tri ekspertë për mbrojtje kundër zjarrit : znj. Ditika Qatipi , Znj Eriona Qatipi dhe znj Nermin Jonuzi – nga angjecia për menaxhimin e emergjencave , mbrojtje dhe Shpëtim e lëshuar nga Ministria e punëve të bredshme e vendit të Origjinës (Republikës së Shqipërisë). **andaj konsiderojmë që ky prentendim nuk qendron dhe është konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë.**

KOMENT I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME PRETENDIMIN NR 2:

Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimin të ofertës tone ka vepruar në kundërshtim me NENI 66 (Përshtshmëria Profesionale) Paragrafi 2- Duke na diskualifikuar apo përjashtuar nga procedurat e prokurimit në bazë të një kërkesë apo pretendimi e cola nuk është precizuar nëdosjen e tenderit

Neni 66
Përshtatshmëria Profesionale

2. Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

Provë – Ne kemi ofruar dy liçensa të Autoritetit Publik nga Vendi I Themelit – Ministria E Punëve të bredshme të Republikës së Shqipërisë nga departamenti I emergjencave- Bazuar në NENI 66 paragafi 2 – Këto liçensa nuk është dashur të Refuzohen.

Udhësimi Administrativë UA NR 12/2017 për hartimin e elaborateve kundër zjarrit shumë qartë që precizon Autorizimin që lëshon AME – Mirpo nuk I refuzon apo diskriminon liçenca apo çertifikate që I lëshojnë vendet e Themelimit pasi është në kundërshtim me NENI 7 të LPP (Barazia në Trajtim –Jo diskriminimi)
Autorizimi apo njohja (Nostrifikimi I Çertifikatës) nuk ka qenë kërkesë e FDT-së dhe të Njoftimi për kontratë.

Njoftim me pretendimi ankimorë 2 :

Autoriteti Kontraktues nuk është në dijeni që ekziston një Marveshje Bilaterale në Mes Republikës Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për bashkpunim në Fushën e Arsimit dhe Shkencës e nëshkruar me datën : 8 Mars 2012 -E ratifikuar nga Prisidenti

Provë : Në kuadër të listës së marveshjes të Qeverisë së Kosovë me vendet tjera , shiko marveshjen NR 38 do ta bashkangjesim edhe në këtë kërkesë për rishqyrtim)

Marrëveshja për Bashkëpunim në Fushën e Arsimit 38 dhe Shkencës	Ne mes te Qeverisë se Republikës se Kosovës dhe Këshillit Ministrit te Republikës se Shqipërisë.	E nënshkruar me 8 Mars 2012 - E ratifikuar nga Presidenti.

Pas ratifikimit të marveshjes nga Presidenca me datë 08.03.2012 – Institucionet me dy qeverive janë të Obliguar ti zbatojmë marveshjet dhe bashkpunim të ndërsjelltë pa procedura byrokratike në fushën e Arsimit dhe Shkencë , që do të thotë shkëmbin dhe njohje të ndërjselltë të diplomave, çertifikatave me qëllim të zhvillimit të tregut të punës dhe bashkpunim ekonomik.

Të gjitha qertifikat dhe diplomat e republikës së Kosovës të lëshuar nga një institucion I akredituar I njefë Republika e Shqipërisë dhe anasjelltas.

Institucionet e Republikës janë të Obliguar ti zbatojnë marveshjet ndërkombëtare.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

- Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ankesën e Grupit të Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K. & TAULANT SHPK i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimin e komisionit profesional vlerësues për aktivitetin e prokurimit "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. prokurimit KEKO-20-093-211 ka vlerësuar se Operatori ekonomik ne ankesën e tij nuk ka prezantuar prova me të cilën e vërteton faktin se vendimi i marr nga autoriteti kontraktues nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në LPP, andaj si i tillë nuk paraqet bazë të mjaftueshme për ndryshimin e vendimit te marre me date 21.10.2020 (i publikuar me dt. 23.10.2020).
- Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marr parasysh dëshmitë e dërguara nga Operatori ekonomik si dhe rekomandimet nga komisioni ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Koment i përgjithshëm :
Demantojmë konkluzonin e përgjitshëm se gjoja nuk kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme , pasi Autoritet Kontraktues nuk ka kërkuar fare sqarimin dhe ka vepruar në Kundërshtim me NENI 38.9 RRUOP (Kërkesë për sqarimin e tenderit) .

39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. **Nënshkrimi digjital nuk është i obligueshem deri ne njoftim zyrtar nga KRPP.**

Nëse ka prova Autoriteti Kontraktues nese ka kërkuar sqarimin e tenderit le ti prezenton – SI ka mundësi të prezentojmë prova ku nuk kanë kërkuar informata lidhur me dokumentacionin tonë të ngarkuar në e-prokurim , të cilën konsiderojmë që i plotësojmë kërkesat e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderushëm të punëtorve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë , tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen **kontekstet.** Vlera e dëmit kap vlerën **120, 000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*